

VENDIM
Nr. 594, datë 15.10.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 1085, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PËR BLERJEN E PAJISJEVE/MJETEVE TË PROJEKTUARA POSAÇËRISHT OSE TË PËRSHTATURA PËR QËLLIME USHTARAKE, SI DHE ARMËT, MUNICIONET APO MATERIALET LUFTARAKE PËR QËLLIME OPERACIONALE, PËRFSHIRË TEKNOLOGJINË DHE *SOFTWARE*-t E LIDHURA ME KËTO MALLRA, SI DHE PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË VEÇANTË TË KLASIFIKIMIT TË KËTYRE KONTRATAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, shkronjat “dh” e “i”, dhe 2, të nenit 5, të ligjit nr. 36/2020, “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1085, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për lidhjen e kontratave për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake, si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operacionale, përfshirë teknologjinë dhe *software*-t e lidhura me këto mallra, si dhe për përbërjen, mënyrën e organizimit e të funksionimit të komisionit të veçantë të klasifikimit të këtyre kontratave”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “a”, e pikës 1, të nenit 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) përcaktimi i rregullave për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake, si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operacionale, përfshirë shërbimet, teknologjinë dhe *software*-t e lidhura me këto mallra, të përjashtuara nga procedurat e prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, që zbatohen nga Ministria e Mbrojtjes dhe nga sipërmarrje publike, ku shoqëritë shtetërore që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e industrisë ushtarake zotërojnë më shumë se 50% të aksioneve apo kuotave për plotësimin e nevojave të tyre.

Këto nevoja duhet të jenë në funksion të projekteve që lidhen drejtpërdrejt me vënien në funksion apo zhvillimin e industrisë ushtarake dhe kanë të bëjnë domosdoshmërisht me elemente apo procese të projekteve të klasifikuara si kontrata për qëllime ushtarake.”

2. Në fund të pikës 1, të nenit 2, shtohen fjalët “... dhe sipërmarrje publike, ku shoqëritë shtetërore që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e industrisë ushtarake zotërojnë më shumë se 50% të aksioneve apo kuotave për plotësimin e nevojave të tyre.”.

3. Pika 26, e nenit 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“26. “Titullari i autoritetit kontraktor”, ministri i Mbrojtjes ose një person i autorizuar prej tij apo administratori i shoqërisë që kryen rolin e autoritetit kontraktor.”.

4. Pikat 1 dhe 2, të nenit 8, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Grupi i punës për hartimin e projektit ngrihet me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor, përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona dhe ka në përbërje të paktën një ekspert të fushës. Në rastet kur autoritet kontraktor është Ministria e Mbrojtjes, në këtë grup pune mund të angazhohen, krahas përfaqësuesve të strukturës përkatëse për modernizimin edhe specialistë të strukturës gjeneruese të kërkesës operacionale.

2. Në rastet kur autoritet kontraktor është Ministria e Mbrojtjes, grupi i punës për hartimin e projektit mund të thërrasë për ekspertizë përfaqësues të strukturave të tjera të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura.”.

5. Pas pikës 2, të nenit 11, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Në rastin e sipërmarrjeve publike të përcaktuara në nenin 1, të këtij vendimi, në përfundim të procesit të negociimit të kontratës, administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme kontratën e negociuar nga Komisioni i Negociimit së bashku me një relacion shpjegues për gjithë procesin e prokurimit.”.

6. Pas nenit 12 shtohet neni 12/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 12/1

Prokurimi i kontratave me objekt të përzier

Kontratat, që kanë, njëkohësisht, si objekt të tyre mallra, pajisje ose shërbime të klasifikuara për qëllime ushtarake dhe, pjesërisht, në zbatim të legjislacioneve të tjera të aplikueshme, prokurohen sipas dispozitave të këtij vendimi.”.

7. Në pikën 2, të nenit 21/1, pas fjalëve “... të paktën 50% ...” shtohen “... të aksioneve apo ...” dhe pas fjalëve “... produktet e prodhuara ...” shtohen “... apo të përshtatura ...”.

8. Pika 3, e nenit 21/2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Në rastet kur shoqëria me kapital shtetëror disponon më pak se 50% të aksioneve apo kapaciteteve të vlerësuara si të nevojshme për realizimin e objektit të kontratës ose nuk zotëron shumicën e kapitalit të nënshkruar të subjektit, që është krijuar për këtë qëllim, Ministria e Mbrojtjes mund të autorizojë drejtpërdrejt këtë të fundit për nisjen e procedurave për realizimin e objektit të kontratës, me produktet e prodhuara apo të përshtatura nga ajo apo nëpërmjet saj, vetëm pasi Komiteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë ka aprovuar për këtë rast furnizimin e Forcave të Armatosura nëpërmjet shoqërisë aksionare me kapital shtetëror.”.

9. Pika 2, e nenit 29, ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Ky komision ka në përbërje përfaqësues të strukturës përgjegjëse për hartimin e kontratave, specialistë të fushave të tjera, në varësi të specifikës së objektit të kontratës, ndërsa në rastet kur autoritet kontraktor është Ministria e Mbrojtjes edhe përfaqësues të strukturës ushtarake, përfituese të mallit ose shërbimit.”.

10. Në nenin 33 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë vijon:

“2. Në rastet kur autoritet kontraktor është Ministria e Mbrojtjes, zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës realizohet nga struktura përgjegjëse për modernizimin, e cila mund të përfshijë në grupin e punës të ngritur për këtë qëllim edhe përfaqësues të strukturës, që ka përgatitur kërkesën operacionale. Ky grup vlerëson realizimin e detyrimeve kontraktore, sipas fazave të realizimit të kontratës dhe përgatit raportin përkatës për fazën, në të cilën është zbatimi i kontratës.

3. Në përfundim të kontratës, për rastet e parashikuara në pikën 2, struktura përgjegjëse për modernizimin përgatit një raport përmbledhës për titullarin e autoritetit kontraktor për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.”.

b) Pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Në rastin e sipërmarrjeve publike sipas përcaktimeve në nenin 1, të këtij vendimi, zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës realizohet sipas një praktike të miratuar, rast pas rasti, nga autoriteti kontraktor.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama